

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Isa Kelmendi dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve ~~rrugorët e tanj, ngarku i~~ dhe ~~rrugorët e~~ nga fshati ~~Gracanici~~, komuna ~~Gracanici~~ të cilët i përfaqeson Bajram Muqaj, avokat nga Peja, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit nga auto përgjegjësia, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 1352/2014 datë 14.1.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 8.4.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 1352/2014 datë 14.1.2019.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, C.nr. 212/2011 datë 30.1.2014, pjesërisht është aprovar si e bazuar kërkesëpadia e paditësve ashtu që është detyruar e paditura që në emër të kompensimit të dëmit nga auto përgjegjësia për aksidentin e komunikacionit të ndodhur më datë 5.8.2011 t'u paguajë:

Paditësit ~~BBT/114/1~~, në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 10.000 €, për frikë shumën prej 8.000 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 32.000 €, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 4.500 €, për shpenzimet e kujdesit dhe ndihmës së huaj shumën prej 600 €, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 6.248 €, në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese-fitimit të humbur shumën prej 77.241,67 € për periudhën duke filluar nga data 5.8.2011 e deri më datën 31.10.2013, si dhe për çdo muaj shumën prej nga 2.874,54 €, duke filluar nga data 31.10.2013, si dhe në të ardhmen gjer sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore,

Paditësit ~~humbur shumë prej 9.000 €~~ në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 9.000 €, përfrikuar shumën prej 8.000 €, përvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 31.000 €, përshtësim trupor shumën prej 4.500 €, përshtësimet e mjekimit shumën prej 261 €, përshtësimet e kujdes dhe ndihmë të huaj shumën prej 600 € dhe në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese-fitimit të humbur shumën prej 4.024 € për periudhën që nga data 5.8.2011 e deri më datën 31.10.2013 si dhe përcdo muaj shumën prej 149,60 € duke filluar nga data 31.10.2013 dhe më tutje gjersa përkëtë të ekzistojnë kushtet ligjore.

E paditura është detyruar që shumat e arritura paditësve t'ua paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit, ndërsa shumat tjera që arrijnë më vonë më së largu deri më datën 05 të muajit vijues e përmuanin e kaluar. Të gjitha shumat e lartë përmendura e paditura është e detyruar që paditësit t'ia paguajë me kamaten ligjore prej 8% në vit nga data 30.1.2013. E paditura detyrohet që paditësve t'iu paguajë edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 4.663 €.

Kërkesëpadia e paditësve përftej pjesës së gjykuar është refuzuar në tërësi si e pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 1352/2014 datë 14.1.2019, është vendosur që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, C.nr. 212/2011 datë 1.4.2014 dhe ankesa e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, C.nr. 212/2011 datë 30.1.2014, të konsiderohet si e afatshrnë. Është refuzuar pjesërisht si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e gjykuar të paditësit ~~humbur shumë~~ përkitazi me kompensimin e dëmit në emër të shpenzimeve përkujdes dhe ndihmë të huaj, ndërsa është ndryshuar në pjesën lidhur me kompensimin përdhimbje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor, ashtu që paditësit ~~humbur~~ në emër të dhimbjeve fizike i është gjykuar kompensimi në shumë prej 7.500 €, përfrikuar shuma prej 4.500 €, përvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shuma prej 13.500 € dhe përshtësim trupor shuma prej 2.500 €. I njëjtë aktgjykim është prishur në pjesën e gjykuar përshtësimet e mjekimit dhe fitimit të ~~humbur~~ përshtësimet e zvogëlimit të aftësisë punuese. Sa i përket paditësit ~~humbur shumë~~ po ashtu pjesërisht është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i lartpërmendur i gjykatës së shkallës së parë në pjesën ku është gjykuar kompensimi përdhimbje fizike, frikë, zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtim trupor dhe shpenzimet e kujdesit dhe ndihmës nga personi i huaj, ashtu që si kompensim përdhimbjet fizike i është gjykuar shuma prej 7.000 €, përfrikuar shuma prej 4.500 €, përvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shuma prej 13.000 €, përshtësim trupor shuma prej 2.500 € dhe përshtësimet e kujdesit dhe ndihmës nga personi i huaj shuma prej 300 €. I njëjtë aktgjykim është prishur në pjesën e kompensimit të gjykuar përshtësimet e mjekimit dhe përfitimit të humbur përfrikuar shumën prej 9.000 €.

shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese, e po ashtu edhe në pjesën e gjykuar lidhur me shpenzimet procedurale.

Shumat e gjykuara e paditura është detyruar që paditësve t'ua paguajë me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim me afat përnjë vit e pa destinim të përcaktuar duke fillua nga data 30.1.2014 kur është dhënë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë e tutje deri në pagesën definitive.

Kërkesëpadia e paditësve përtet shumave të gjykuara është refuzuar si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësit me kohë kanë paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i goditur me revizion ashtu që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkësëpadia e paditësve.

E paditura në përgjigje të revizionit kundërshton thëniet e pretendimet e revizionit dhe propozon që revizioni i paditësve të refuzohet si i pabazuar, duke shtuar edhe se e paditura ka përbushur në tërësi të gjitha detyrimet, duke ua bërë paditësve pagesën e kompensimit të dëmit sipas aktgjykimit të goditur me revision në shumën e përgjithshme prej 65.240,00 €, më datë 1.3.2019.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), shqyrtoi akt gjykimin e goditur me revizion dhe qjeti se:

Revizioni i paditësve është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se baza juridike e kërkesëpadisë nuk është kontestuese, ngase e paditura përveç tjerash edhe ka ekzekutuar në favor të paditësve aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Apelit. Kontestuese në mes palëve vazhdon të mbetet lartësia e kompensimit të gjykuar. Në bazë ekspertizës mjekësore të Dr. Isa Kaliçani, ortoped traumatolog, Dr. Muhamet Halitaj, psikiatër, Dr. Kujtim Zajmi, Dr. Armend Kërveshi-neokirurg në QKUK Prishtinë dhe Dr. Edmond Shabi, maksillofacial dhe mendimit të përbashkët të tyre pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësve, rezulton se paditësi ~~është~~ në aksidentin e lartpërmendur të datës 5.5.2011 ka pësuar këto lëndime të renda trupore, thyerje e procesit avolar të masillës, thyerje e diattines së radiusit të djathë, thyerje në regjionin e nyjës tarorurale të majtë, thyerje në regjionin e kërcërit të djathë, thyerje e trupit të unazës L3 dhe L4 të mesit, gërvishje në regjionin e kokës e të mjekrës, thyerje të eshtrave të hundës, stabilizim i pas intervenimit kirurgjik në unazën L2 dhe L5 ose sintezë e radiusit të djathë e kërcërit të djathë dhe zogut të këmbës së majtë. Si pasojë e këtyre lëndimeve trupore, paditësi ~~është~~ ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë me kohëzgjatje dhe intensitet të ndryshëm zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 45.125%, shërmim të mesëm trupor, dhe po ashtu ka pasur nevojë për kujdesin e personit të huaj në kohëzgjatje prej 3 muaj.

Në bazë të ekspertizës mjekësore të ekspertëve të lartë përmendur dhe mendimit të përbashkët të tyre rezulton se paditësi ~~lëndimeve~~ në aksidentin e lartë përmendur të komunikacionit ka pësuar këto lëndime të rënda trupore, thyerje komunitive e qafokut të djathtë, nxjerrje e kërdhokllës së majtë si pasojë e aksidentit, tronditje të trurit, ndrydhje koke dhe trupi dhe gërvishje të fytyrës, ku si pasojë e këtyre lëndimeve të rënda trupore paditësi ~~lëndimeve~~ ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë me intensitet dhe kohëzgjatje të ndryshme, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 40%, shëmtim të mesëm trupor, ka pas nevojë për kujdesin dhe ndihmën e huaj në kohëzgjatje prej gjashtë javësh.

Në një gjendje faktike të vërtetuar kësisoj gjykata e shkallës së parë duke gjetur se e paditura është përgjegjës për kompensimin e dëmit ndaj paditësve, e duke pasur parasysh lëndimet trupore të paditësve të përshkruara më lartë, format e dëmit jo material dhe material që paditësve iu janë shkaktuar me rastin e këtij aksidenti, moshën e paditësve, paditësit ~~lëndimeve~~ i lindur më ~~193~~ ndërsa paditësi ~~lëndimeve~~ i lindur më ~~193~~, si dhe në bazë të bindjes së lirë e në pajtim me nenin 193 dhe 200 të LMD, paditësve iu ka caktuar kompensimin e dëmit në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore duke pranuar pjesërisht si të bazuar ankesën e të paditurës ka ndryshuar aktgjykimin e lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë duke zvogëluar shumën e gjykuar në emër të dhimbjeve fizike, frikës, zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe shëmtimit trupor, në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj, ku kompensimin për shpenzimet e kujdesit dhe ndihmës së huaj për paditësin ~~lëndim~~ e ka vërtetuar ndërsa për paditësin ~~lëndim~~ e ka ndryshuar nga 600 në 300 €, e bindur plotësisht se me një shumë të tillë të gjykuar nga ana e kësaj Gjykate duhet të arrihet plotësisht realizimi i qëllimit shoqëror për të cilin është paraparë kompensimi i këtij dëmi dhe këto shuma për paditësit nuk paraqesin qëllime fitimprurëse.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ndryshimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe lidhur me pjesën vërtetuese të tij, pasi që ky aktgjykim nuk përfshihet me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale në të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e paditësve të paraqitura në revizion kanë të bëjnë me vlerësimin e paditësve se shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së dytë për format e dëmit jo material prezentë tek paditësit janë të ulëta dhe jo reale, e po ashtu edhe kamata e gjykuar është e paqartë.

Këto pretendime të revizionit Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara për të njëjtat shkaqe dhe arsyet e dhëna nga ana e gjykatës së shkallës së dytë, e të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. Është e natyrshme se me këtë kompensim tek paditësit nuk mund të kthehet gjendja e më parme para aksidentit, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se shumat e gjykuara për paditësit vërtet paradesin një sadisfacion real për të përballuar sadopak dhimbjet e tyre shpirtërore të mëdha të shkaktuara nga ky aksident, me përbushjen e nevojave të ndryshme jetësore me këtë kompensim. Përndryshe kompensimi i gjykuar paditësve është në përputhje të plotë edhe me praktikat e mira gjyqësore në rastet e ngashme të caktimit të kompensimit, dhe një kompensim i tillë për nga lartësia e tij nuk bie ndesh me qëllimin dhe tendencat të cilat janë të papajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe me qëllimin shoqëror për të cilin parashihet ky kompensim, kërkesa këto të parapara me nenin 200 paragrafi 2 të LMD. Me aprovin eventuale të shumave më të larta të kompensimit sigurisht që kompensimi si i tillë do të ishte në kundërshtim me këto kritere të parapara me ligj. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e caktimit të kompensimit ka pasur parasysh të gjitha kriteret relevante për caktimin e kompensimit të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit, andaj refuzohen si të pabazuara pretendimet e revizionit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e caktimit të shumës së kompensimit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Edhe pretendimi tjetër i revizionit që ka të bëjë me kamaten e gjykuar refuzohet si i pabazuar ngase kamata e gjykuar nuk është e paqartë, ajo ka përbajtjen ashtu siç parashihet me ligj, përkatësisht me nenin 277 të LMD, ku me rastin e përllogaritjes së saj nuk mund të paraqiten paqartësi e as vështirësi.

Për shkaqet dhe arsyet e paraqitura më lartë, si dhe për atë se revizioni i paditësve nuk mund të vë në dyshim aktgjykimin e goditur me revizion, revizioni i paditësve u refuzua si i pabazuar. Andaj, me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Rev.nr.93/2019, më 8.4.2019

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani